**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**CA.nr.2650/2016**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË,** kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gani Avdiu Kryesues, Valon Totaj e Milena Đerić, - anëtarë, (më tej kolegji) në kontestin e paditësve: S.D. dhe B.D., të dy nga Gjilani, Rr... pa nr. të përfaqësuar nga A.I., av. në Gjilan, kundër të paditurve: L.M. dhe Q.M., nga Gjilani, Rr..., të përfaqësuar nga përfaqësuesi i përkohshëm F.B. e SH.D., nga Gjilani, Rr. ..., I.Q., nga Gjilani, Rr. "... dhe A.H. nga Gjilani, Rr. "... i përfaqësuar nga SH.P., av. në Gjilan, për pagesën e borxhit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të paditurit, të parë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.384/2015 të dt.29.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 14.02.2020 jep:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pathemeltë ankesa e të paditurit L.M., e paraqitur nga përfaqësuesi i tij av. V.P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.384/2015 i dt.29.04.2016, V**ërtetohet**.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.384/2015 i dt.29.04.2016, në raport me të paditurin Q.M., **nuk është ekzaminuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin C.nr.384/2015 të dt.29.04.2016, ka vendosur si vijon:

"Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e S.D., dhe B.D., kundër të paditurve, L.M. dhe Q.M., nga Gjilani dhe detyrohen të paditurit që paditësve në emër të përmbushjes së pjesës së borxhit të mbetur t'ia paguajnë shumën e të hollave në lartësi prej 30.000,00 €, për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme, përkatësisht ngastra kadastrale nr...., me kulturë shtëpi e oborr, në sipërfaqe prej gjithsejta 0.05,00 ha, e regjistruar sipas fletës poseduese nr. ... ZK Gjilan, me kamatën që do ti llogaritet në lartësinë sa e paguajnë qytetarët pa destinime të veçanta, në Bankat afariste të Republikës së Kosovës, dhe të nga data

12.02.2009, e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me vërejtje të përmbarimit të detyruar.

Konsiderohet, e tërhequr padia , ndaj I.Q., për shkak se ka vdekur, ndaj SH.D. dhe A.H., për shkak se nuk kishin legjitimitet real pasivë në këtë çështje kontestuese dhe reduktimit të kërkesëpadisë, e cila do të mbetet objekt i kërkesëpadisë vetëm pagesa e borxhit për deri sa se paditësit e kanë tërhequr kërkesëpadinë për prishen e kontratës për shitblerjen e pasurisë të paluajtshme ... e vërtetuar me dt.07.02.2007, nga Gjykata Komunale në Gjilan.

Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, shfuqizohet, aktvendimi C.nr.65/2009 i dt. 15.07.2009, nga Gjykata Komunale në Gjilan, lidhur me caktimin e masës së përkohshme e sigurisë.

Detyrohen të padituri L. dhe Q.M., t'ia paguajnë paditësve S. dhe B.D., shpenzimet e procedurës kontestimore si vijon: për hartimin e e padisë shumën prej 80,00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 250,00 €, për 5 seanca të përfaqësimit sipas T.A rë re nga 135,00 €, e gjithsejtë 675,00 në emër të përfaqësuesit të përkohshëm shumën prej 3275,00 €, të gjitha këto të llogaritura në lartësi prej 1.880,00 €, ndërsa detyrohen paditësit L. dhe Q.M., t'ia paguajnë të padituri A.H., shpenzimet e procedurës si vijon: për hartimin e përgjigjes në padi shumën prej 80,00 €, për 5 seanca të plota të përfaqësimit sipas T.A vjetër nga 100,00 €, gjithsejtë 500,00 për 5 seanca të përfaqësimit sipas T.A rë re, nga 135,00,gjtihsejtë 685,00 €, të gjitha të llogaritura në lartësi prej 1.255,00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit , me vërejtje të përmbarimit të detyruar".

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i padituri L.M., av. V.P., me datën 31.05.2016, ka paraqitur një ankesë, me të cilën ka kërkuar që aktgjykimi ankimor të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit kundër të padituri të refuzohet si e pa themeltë, ose i njëjti të prishet çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim, duke parashtruar këto shkaqe: *Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*

Fakte dhe prova të reja me ankesën e parashtruar nuk janë paraqitur përkatësisht propozuar.

*Përgjigje në ankesë është paraqitur.*

*Kompetenca*: Gjykata e Apelit, kolegji duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare vlerësoi se ka juridiksion për procedim dhe vendimmarrje në këtë çështje juridike, duke u bazuar në nenet: 17 e 18 të Ligjit për Gjykatat, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 79/2010).

*Vlerësimi i ankesës*: Kolegji në bazë të shkresave të lëndës (fletë kthesës si dëshmi për dorëzimin e aktgjykimit të shkallës së parë, palës ankuese si dhe zarfit për dorëzimin e ankesës në postë) konstatoi se ankesa është paraqitur në afat ligjor, është e lejueshme dhe e plotë, pra i përmbush kërkesat ligjore nga nenet 176, 178 e 186 të Ligjit për

Procedurën Kontestimore, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 38/08, i datës 20 shtator 2008), i cili ka hyrë në fuqi me 6 tetor 2008 (më tej LPK).

*Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë*: Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në bazë të nenit 194, të LPK, e ekzaminoj aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesa si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale dhe për shkeljen e dispozitave kontestimore dhe gjeti se:

*Ankesa është e pathemeltë***.**

Kolegji, konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë zbatimit të procedurës kontestimore, nuk ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafët b, g, j, k dhe m) të LPK, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje tjera të theksuara në ankesë, e të cilat do të ishin me ndikim në vendim marrje të drejtë dhe të ligjshme në këtë çështje kontestimore.

Aktgjykimi ankimor përmban arsye të plota dhe të qarta, ai nuk është në kundërshtim me dispozitivin e tij, e as me provat që janë marrë gjatë shqyrtimit të çështjes në shkallë të parë.

*Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike:*

Nga shkresat në dosje rezulton se gjykata e shkallës së parë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes i ka marrë provat e përshkruara në procesverbalin përkatës dhe ka konstatuar gjendjen faktike të përshkruar në arsyetimin e aktgjykimit ankimor si vijon: Përfaqësuesi i të paditurit, L.M., i autorizuari V.P., në procesverbalin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes me dt.14.11.2011:

"Unë kam bisedar me telefon dy herë pas seancën së dt. 31.10.2011, ai më ka thënë se do të vij në Gjilan dhe do të takohem me ty, që ta përmbush obligimin kontraktues dhe e njoftoj gjykatën se L.M., nuk ka ardhur në Gjilan, dhe nuk e ka përmbush obligimin e tij kontraktues për pagesën e shumës prej 30.000,00 €". Nga marrëveshja jashtë gjyqësore e dt.07.08.2008, e lidhur në mesë të S. dhe B.D. si shitës i patundshmërisë, dhe L. dhe Q.M., blerës, konstatohet se i padituri është pajtuar që së bashku me vëllain e tij Q.M.n në mënyrë solidare përfundimisht të paguajnë shumën e borxhit prej 30.000,00 në emër të shitblerjes së patundshmërisë përkatëse, përfundimisht me dt. 15.08.2009.

Në bazë të kësaj gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë kishte vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

*Pretendimet ankimore*: përfaqësuesi i të paditurit av. V.P., në ankesë ka pohuar se aktgjykimi ankimor është dhënë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 i) të LPK, e cila konsiston në faktin se është refuzuar kërkesa që si palë në procedurë, të dëgjohet i padituri Q.M.. Dëgjimi i kësaj pale do të sqaronte rrethanat se kush e ka blerë këtë patundshmëri, përkatësisht se kush ka obligim që të paguaj shumën e mbetur prej 30.000,00. Andaj, në këtë rast, gabimisht është konstatuar gjendja faktik.

Përfaqësuesi i paditësve av. A.I., *në përgjigjen në ankesë* ka pohuar, së përfaqësuesi i paditësit, av. V.P., ka hequr dorë nga përfaqësimi i të paditurit L.M., (në seancën e dt.01.02.2016), me arsyetim se nuk ka mundësi të kontaktoj me të.

Më tej, në përgjigje në ankesë, përfaqësuesi i paditësve ka pohuar, se gjykata e shkallës së parë, në rigjykim duke vepruar sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit CA.nr.3686/2012 të dt.13.01.2015, të paditurit Q.M., i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm av. F.B..

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, të shprehur në aktgjykimin ankimor, kolegji e vlerëson si të bazuar në ligj dhe të drejtë, sepse ai nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike, në këtë rast është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, ndërsa e drejta materiale, nga gjykata e shkallës së parë drejtë është zbatuar drejtë.

Kolegji, konstaton se nuk janë kontestuese faktet se tani paditësit S. D. dhe B.D., me dt.07.08.2008, kishin lidhur Marrëveshjen jashtë gjyqësore, me tani të paditurit L.M. e Q.M., sipas të cilës të paditurit ishin obliguar që paditësve në emër të shitblerjes së dy shtëpive që gjenden në Gjilan të ndërtuara në ngastrën kadastrale nr.... në sipërfaqe prej 500 m2 ZK Gjilan, t'ua paguajnë shumën prej 30.000 €, me dt.15.08.2009 në emër të çmimit të blerjes.

Të paditurit deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, e as në procedurë sipas ankesës nuk dëshmuan, se e kanë përmbush borxhin ndaj paditësve, sipas marrëveshjes jashtë gjyqësore të dt.07.08.2008.

Baza ligjore e kërkesëpadisë:

Me nenin 262 të LMD së ish Jugosllavisë (të vitit 1978 si dhe ndryshim plotësimet e tij) është përcaktuar: *"Kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit, të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush me ndërgjegje krejtësisht sikur është përmbajtja e tij"*.

Me nenin 414 të LMD është përcaktuar: *" Secili debitorit i detyrimit solidar i përgjigjet kreditorit për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkoj përmbushjen e tij, nga cili dëshiron gjithnjë gjerës të mos përmbushet tërësisht, por kur një debitor ta ketë përmbushur detyrimin ai pushon të gjithë debitorët shkarkohen".*

Ndërsa me nenin 516 të të njëjtit ligj është përcaktuar: *"Blerësi ka për detyrë ta paguaj çmimin në kohën dhe në vendin e cekur në kontratë".*

Ndërgjyqësit, kishin lidh marrëveshjen jashtë gjyqësore të dt.07.08.2008, sipas të cilës ishin detyruar në mënyrë solidare, që paditësve në emër të shitblerjes së patundshmërisë (së përshkruar në tekstin e marrëveshjes), t'ua paguajnë shumën prej 30.000 € me dt. 15.08.2009, andaj, kolegji vlerëson se kërkesëpadia e paditësve kundër të paditurit L.M., si borxhli solidar me të paditurin Q.M., ishte e themeltë, sepse i padituri nuk dëshmoi se ai personalisht ose vëllai i tij i padituri Q.M., e kanë përmbush detyrimin ndaj paditësve.

Andaj, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë rast drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, respektivisht dispozitat ligjore të neneve 262, 414 dhe 516 të LMD, (së vitit 1978) kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor.

Nuk është i vetëmjaftueshëm vetëm pretendimi ankimor i palës ankuese përkatësisht përfaqësuesit të saj, por pretendimi i tillë, duhej të bazohej në fakte relevante, prova të besueshme dhe të mjaftueshme, që të provohet themelësia e ankesës së tillë, në raport me aktgjykimin ankimor.

Pra në këtë rast përfaqësuesi i të paditurit L.M., av. V.P., nuk arriti të dëshmoj me fakte dhe prova relevante se i padituri L., nuk i kishte borxh të paditurve shumën e cekur në kërkesëpadi sipas marrëveshjes të lartë cituar.

Kolegji duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 194 të LPK, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në raport me të paditurin Q.M., nuk e ka ekzaminuar, pasi që aktgjykimi përkatës në raport me këtë të paditur, nuk ishte i goditur me ankesë.

Me sa u tha më lartë kolegji vlerëson se janë përmbushur kërkesat ligjore nga neni 200 i LPK, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË**
**CA. nr.2650/2016 dt.14.02.2020**

**Kryesuesi i Kolegjit – gjyqtari**
**Gani Avdiu**